



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3607 Prot

Vlorë, më 20.02. 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____. 2026

PËR

**DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKB-NË NR. 98 DATË 27.11.2025 “PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA – 2026”**

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 113, Ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 54 pika ç, d dhe dh, të Kreut IX, neni 64 pika c të Kreut X, Ligjin nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, VKM-në nr. 103, datë 11.2.2026 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”;

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimet në klasën dhe shtesën për pozicion të pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake, si më poshtë:

Policia Bashkiake


Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtör	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-2	80,000
Inspektor i Policisë Bashkiake		67,000
Punonjës i Policisë Bashkiake		63,000
ND/MB		47,000

a. Miratimin e shtesës për vjetërsi në punë në masën:

i. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.
 - b. Punonjësit e Policisë Bashkiake përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.
2. Punonjësit e Policisë Bashkiake do të përfitojnë shtesë për vështirësi në punë 4.000 (katër mijë) lekë muaj.
 3. Efektet financiare të ndryshimeve në nivelin e pagave do të përballohen nga Buxheti i Bashkisë Vlorë 2026.
 4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit.
 5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 3607 prot.

Vlorë, më 2002 2026

RELACION
PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB-NË NR. 98 DATË 27.11.2025 “PËR
MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA – 2026”

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b, të Kreut III, neni 54 pika ç dhe dh, Kreu IX, neni 64, pika a, b, c, ç dhe d të Kreut X, është kompetencë e Këshillit Bashkiak miratimi i nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me projektvendimin e paraqitur në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, ju informojmë se:

Për pikën 1. Të miratojë ndryshimet në klasën dhe shtesën për pozicion të pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake, si më poshtë:

Policia Bashkiake

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-2	80,000
Inspektor i Policisë Bashkiake		67,000
Punonjës i Policisë Bashkiake		63,000
ND/MB		47,000

- a. Miratimin e shtesës për vjetërsi në punë në masën:
- i. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

ii. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.

b. Punonjësit e Policisë Bashkiake përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.

Bashkia Vlorë propozon ndryshimet e pasqyruara në tabelën e mësipërme për nivelin e pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake. Niveli i pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake nuk ka patur ndryshime prej vitit 2023. Me miratimin e VKM-së nr. 328, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, për të gjitha kategoritë e punonjësve në njësitë e vetëqeverisjes vendore ka patur rritje të vazhdueshme, ndërkohë për punonjësit e policisë Bashkiake nivel i pagave nuk ka ndryshuar, në mungesë të refencave të cilat nuk janë më pjesë e Vendimit të Këshillit të Ministrave.

Bashkia Vlorë ka pasur korrespondencë me Ministrinë e Pushtetit Vendor për referencë të re të pagave për Policinë Bashkiake, Ministria ka caktuar Këshillin Bashkiak si organin që do të përcaktojë nivelin e pagave të punonjësve të Policisë Bashkiake. Në kushtet kur të gjitha kategoritë e punonjësve kanë patur rritje të nivelit të pagave, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak miratimin për nivelin e ri të pagave për punonjësit e Policisë Bashkiake.

Ju faleminderit!

Konceptoi: L.Nebiu

H.Haxhiu

M.Mishgjoni

